

Raport Monitorimi i realizimit të zbatimit të Planit të Integritetit 2023

Bashkia Roskovec

Përmbajtja

| | |
|--|-------------------------------------|
| I. Hyrje | Error! Bookmark not defined. |
| I. Monitorimi i PI për bashkinë Roskovec Viti 2023..... | Error! Bookmark not defined. |
| I.1 Qasja Vlerësuese..... | Error! Bookmark not defined. |
| I.2 Metodologjia e vlerësimit. | Error! Bookmark not defined. |
| I.3 Mbledhja dhe analiza e të dhënave. | Error! Bookmark not defined. |
| II. Gjetjet e Raportit..... | Error! Bookmark not defined. |
| III. Konkluzione dhe Rekomandime | Error! Bookmark not defined. |

Lista e Figurave

| | |
|--|-------------------------------------|
| Figura 1: Statusi i Zbatimit të Masave..... | Error! Bookmark not defined. |
| Figura 3: Statusi i Zbatimit të Masave, Objektivi I | Error! Bookmark not defined. |
| Figura 4: Statusi i Zbatimit të Masave, Objektivi II..... | Error! Bookmark not defined. |
| Figura 5: Statusi i Zbatimit të Masave, Objektivi III..... | Error! Bookmark not defined. |

Hyrje

Integriteti institucional dhe lufta kundër korrupsionit konsiderohen si një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare. Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit në kryerjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative.

Miratimi dhe monitorimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore është jetësuar nëpërmjet koordinimit dhe zbatimit të nismave anti-korrupsion të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015-2023. Ndërkohë menaxhimi i riskut të integritetit për NJVV-të, si proces në vetëvete rrjeth nga objektivi specifik (objektivi A11) i SNKK dhe Planit të Veprimit (2018-2023), miratuar me VKM nr.516, datë 1.7.2020, si dhe qëllimit politik 5 të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-20230 (SNDQV) - objektivi specifik 5.2: “Nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin”, miratuar me VKM nr.252, datë 21.04.2023”. Ky proces vjen në linjë edhe me rekomandimet e Komisionit Evropian (2018) për Shqipërinë në kuadër të integritetit në Bashkimin Evropian, ku një nga rekomandimet e dhëna është zbatimi i dokumentit të Strategjisë Kundër Korrupsionit, duke iu referuar konkretisht mungesës së një sistemi funksional të menaxhimit të integritetit në institucionet publike në vend.

Procesi i menaxhimit të riskut të integritetit në nivel vendor, ka një qasje gjithëpërfshirëse ku angazhohen të gjitha strukturat e brendshme të bashkisë. Ndërsa hapi i parë i tij lidhet me hartimin e Planit të Integritetit për njësinë vendore (detajuar ky i fundit edhe me një Plan Veprimi 3-vjeçar), monitorimi dhe raportimi i planit të integritetit është etapa tjetër e menaxhimit të riskut në bashki. Monitorimi është periodik (çdo vit) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve dhe drejtuesve të bashkisë, për zbatimin e masave të miratuara për trajtimin e risqeve, në përputhje me përgjegjësitë që ata kanë. Ndërkaq raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e Planit të Veprimit për risqet e integritetit, sipas afateve kohore të parashikuara, për periudhën e kërkuar, për statusin e zbatimit të tyre për problematikat e hasura në zbatim si dhe përmban të dhëna për veprimtarinë e brendshme kontribuese, referuar kuadrit të brendshëm rregullator, burimeve njerëzore profesionale të qëndrueshme, si dhe transparencës e komunikimit me grupet e interesuara.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) në kuadër të funksioneve të saj për realizimin e objektivave të Qeverisë Shqiptare për garantimin e qeverisjes së mirë, ka vijuar me procesin e monitorimit të zbatimit të planeve të integritetit në nivel bashkie për vitin 2023. Raporti i monitorimit është hartuar në përputhje me metodologjinë e monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qëndrore. Analiza e të dhënave dhe vlerësimi i progresit të zbatimit të Planit të Veprimit të Planit të Integritetit për këtë periudhë raportimi është bërë në zbatim të Urdhrit nr. 553, datë 30.09.2021 “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qëndrore”.

Raporti i Monitorimit të PI për bashkinë Roskovec Viti 2023.

Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të bashkisë Roskovec për vitin 2023, është i pari dokument i hartuar në përputhje me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë 553, datë 30.09.2021.

Në Planin e Integritetit të bashkisë , janë përcaktur gjithsej 3 objektiva, për të cilat janë parashikuar fushat me risk dhe masat dhe aktivitete për realizimin e tyre, si vijon:

- **Objektivi I** “Zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki për konsolidimin e një administrate të qëndrueshme dhe profesionale”
- **Objektivi II** “Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe strategjik të bashkisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit”
- **Objektivi III** “Forcimi i transparencës proaktive dhe llogaridhënies publike “
- **Objektivi IV** Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë “


Plani i Integritetit, është konceptuar i shtrirë në një periudhë 3-vjeçare dhe konkretisht 2023-2026. Për bashkinë Roskovec Plani i Integritetit për periudhën Janar-Dhjetor 2023, referuar në planin e veprimit janë planifikuar për tu realizuar 46 aktivitete/masa për tu realizuar.

Situata e monitorimit të Planit të Integritetit të bashkisë Roskovec për periudhën janar – dhjetor 2023, rezulton si më poshtë:

Nga monitorimi i procesit rezulton se, në totalin prej 46 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2023, janë **realizuar** 28 masa/aktivitete ose 61% , **në proces realizimi** 11 masa/aktivitete ose 24% dhe **të porealizuara** 7.masa/aktivitete ose 15% .

| Bashkia Roskovec | Masa dhe Aktivitete | Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve | | | |
|---------------------|--|--|---|-------------------------------------|---|
| | | Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023 | Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara | Masa dhe aktivitete në proces | Masa dhe aktivitete të porealizuara |
| | Realizimi në total i objektivave të PI | 46 | 28 | 11 | 7 |

STATUSI I ZBATIMIT TË MASAVE



Sa më sipër, gjatë vitit 2023, bashkia Roskovec ka hartuar dhe miratuar disa dokumente strategjike për aspekte të veçanta të integritetit, në përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator e institucional në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit, zhvillimin e burimeve njerëzore, rritjen e rezistencës institucionale ndaj risqeve të integritetit si dhe në drejtim të rritjes së nivelit të transparencës e besueshmërisë së publikut..

Qasja Vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të planit të integritetit të bashkisë përmban një analizë të përgjithshme të zbatueshmërisë dhe progresit të vitit 2023, për aktivitete dhe masat të kuadrit riskut në fusha të vecanta të përgjegjësisë rregullator të performancës institucionale, si dhe për ti rezistuar shkeljeve të integritetit.

Metodologjia e vlerësimit.

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të dhënë nga drejtoritë dhe strukturat teknike të bashkisë, bazuar në aktivitetet dhe masat e parashikuara për zbatim për vitin 2023, në planin e veprimit të Planit të Integritetit dhe ecuria e deritanishme e tyre.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave.

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatori i Integritetit të bashkisë në përmbushje të rolit të tij si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen dhe analizën e informacionit mbi ecurinë e raportit të monitorimit.

Gjetjet e Raportit

Objektivi I “Zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki për konsolidimin e një administrate të qëndrueshme dhe profesionale”


Ky objektivi synon konsolidimin e një administrate të qëndrueshme dhe profesionale nëpërmjet përmirësimit të proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore konsolidimi i të cilave do të kontribuojë në forcimin e rezistencës institucionale anti korrupsion.

Ky objektivi për vitin 2023 përmban 11 masa/aktivitete specifike të planifikuara për tu zbatuar nga njësitë e përfshira, nga të cilat janë realizuar 7 masa/aktivitete ose 64%, janë në proces 2 masa/aktivitete ose 18%, dhe 2 masa/aktivitete të porealizuara ose 18% sipas tabelës dhe grafikut si më poshtë:

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat/ aktivitetet planifikuar për këtë objektivi sipas tabelës dhe grafikut, si më poshtë:

| Objektivi | Masa dhe Aktivitete | Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve | | | |
|---|---------------------|--|--|-------------------------------|-------------------------------------|
| | | Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023 | Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara | Masa dhe aktivitete në proces | Masa dhe aktivitete të porealizuara |
| I | | | | | |
| Zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki për konsolidimin e një administrate të qëndrueshme dhe profesionale” | | 11 | 7 | 2 | 2 |

REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Për këtë periudhë monitorimi Janar - Dhjetor 2023 ky objektivi është realizuar në masën 64% ku rezulton se janë realizuar masat /aktivitetet si më poshtë:


- Ngritja e komisionit të përhershëm disiplinor;
- Organizimi i trajnimeve për punonjësit e angazhuar me prokurimet publike;
- Alokimi i kohës së mjaftueshme të punës së koordinatorit për të drejtën e informimit në raport me detyrat e tjera që kryen;
- Mundësimi i trajnimit të personelit të Auditit të Brendshëm;
- Organizimi i tykimeve informuese për punonjësit në lidhje me procedurat e sinjalizimit dhe legjislacionin përkatës;
- Vlerësimi i nevojave për burime njerëzore dhe infrastrukturë teknike në IMT etj;

Objektivi II “Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe strategjik të bashkisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit”

Ky objektivi synon të përmirësojë, rishikojë dhe plotësojë kuadrin e brendshëm rregullator në disa fusha të veçanta të etikës dhe integritetit, për të siguruar përputhshmëri të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, strukturën institucionale si dhe për të qartësuar disa funksione dhe detyra në bashki.

Gjatë periudhës raportuese lidhur me këtë objektiv janë planifikuar për vitin 2023 për tu realizuar 23 masat/aktivitete nga të cilat janë realizuar 16 masa/aktivitete ose 69%, janë në proces realizimi 4 masa/aktivitete ose 17%, dhe nuk janë 3 masa/aktivitete ose 14% realizuar sipas tabelës dhe grafikut si më poshtë:

| Objektivi II | Masa dhe Aktivitete | Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve | | | |
|---|---------------------|--|--|-------------------------------|-------------------------------------|
| | | Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2023 | Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara | Masa dhe aktivitete në proces | Masa dhe aktivitete te perealizuara |
| Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe strategjik të bashkisë në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit | | 23 | 16 | 4 | 3 |



Për këtë periudhë monitorimi Janar - Dhjetor 2023 ky objektivi është realizuar në masën 69 % ku rezulton se janë realizuar masat /aktivitetet si më poshtë:

- Parashikimi në rregulloren e brendshme i detyrave dhe funksioneve të koordinatorit për të drejtën për informim dhe koordinatorit për njoftim dhe konsultim publik;
- Parashikimi në rregulloren e brendshme i linjave të komunikimit të brendshëm ;
- Miratimi i urdhrave të titullarit për caktimin e autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave dhe detyrat përkatëse të tij;
- Informimi i punonjësve lidhur me rolin e autoritetit përgjegjës;
- Hartimi dhe miratimi i rregullave të brendshme në lidhje me ruajtjen ,mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve;
- Rishikimi i rregullores së brendshme lidhur me detyrat e çdo drejtorie për sa i përket kontributit në hartimin e dokumentave financiare të bashkisë etj;


Objektivi III “Forcimi i transparencës proaktive dhe llogaridhënies publike”.

Transparenca e bashkisë gjatë procesit të zbatimit të politikave vendore është shumë e rëndësishme për rritjen e pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm në veprimtarinë e bashkisë dhe të publikut në tërësi. Në këtë kuadër, është me rëndësi edhe sigurimi i pjesëmarrjes së publikut në procesin e identifikimit të prioriteteve strategjike afatgjata. Për këtë arsye, bashkia angazhohet të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit, gjatë hartimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave të ndryshme vendore.

Gjatë periudhës raportuese lidhur me këtë objektivi janë planifikuar për vitin 2023 për tu realizuar 6 masat/aktivitete nga të cilat janë realizuar 3 masa/aktivitete ose 50% janë në proces 1 masë/aktivitet ose 17% dhe nuk janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 33%, sipas tabelës dhe grafikut si më poshtë:

| Objektivi | Masa dhe Aktivitete | Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve | | | |
|--|---------------------|--|--|-------------------------------|------------------------------------|
| | | Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023 | Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara | Masa dhe aktivitete në proces | Masa dhe aktivitete të përfunduara |
| III | | | | | |
| Forcimi i transparencës proaktive dhe llogaridhënies publike | | 6 | 3 | 1 | 2 |

REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Për këtë periudhë monitorimi Janar- Dhjetor 2023, bashkia ka realizuar, masat dhe aktivitete si më poshtë:

- Organizimi i fushatave të përgjithshme ndërgjegjësuese duke përdorur mediat sociale të bashkisë për të nxitur pjesëmarrjen e publikut në proceset e konsultimit publik;
- Ristrukturimi i programit të transparencës duke mundësuar publikimin e materialeve në formate lehtësisht të aksesueshme për publikun etj;
- Publikimi i informacionit për shërbimet publike dhe shërbimet administrative në programin e transparencës;


Objektivi IV “Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë”.

Ky objektivi synon menaxhimin e riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë, duke u fokusuar në proceset e punës të vlerësuara si më të ekspozuarat ndaj rrezikut të korrupsionit. Në tërësinë e tij, menaxhimi i integritetit i Bashkisë paraqet sfida të cilat hasen më së shumti në fusha të veçanta të përgjegjësisë, të tilla si: fusha e menaxhimit financiar, auditimi, menaxhimi i pronave të bashkisë, shërbime publike, arkivimi si edhe planifikimi i territorit.

Gjatë periudhës raportuese lidhur me këtë objektiv janë planifikuar për vitin 2023 për tu realizuar 6 masat/aktivitete nga të cilat janë realizuar 2 masa/aktivitete ose 30% dhe janë në proces 4 masa/aktivitete ose 40% dhe nuk ka asnjë masë të pararealizuar, sipas tabelës dhe grafikut si më poshtë:

| Objektivi IV | Masa dhe Aktivitete | Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve | | | |
|---|---------------------|--|--|-------------------------------|-------------------------------------|
| | | Masa dhe aktivitete të parashikuara per vitin 2023 | Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara | Masa dhe aktivitete në proces | Masa dhe aktivitete te porealizuara |
| Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë | | 6 | 2 | 4 | 0 |

REALIZIMI I MASAVE DHE AKTIVITETEVE



Për këtë periudhë monitorimi Janar- Dhjetor 2023 ky objektivi është realizuar në masën 30% ku rezultojnë të realizuara masat /aktivitetet si më poshtë:

- Ndryshimi i strukturës për të përfshirë në të njësinë përgjegjëse për monitorimin e shërbimëve publikegritja e strukturës së auditit të brendshme;
- Ngritja e sistemit të monitorimit dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit;

Gjetje të tjera:

- ✚ Të vijohet puna në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe ngritjes së kapaciteteve teknike;
- ✚ Të vijohet puna lidhur me inventarizimin e administrimit të pronave bashkiake, për specifikimin e kategorisë, gjendjes dhe situatës së pronave të bashkisë dhe buxhetimit të një fondi të dedikuar për procesin e hipotekimit të pronave të inventarizuara të bashkisë;
- ✚ Të organizohen trajnime në lidhje me procesin e buxhetimit si atë vjetor edhe për atë afatmesëm;
- ✚ Informimi i punonjësve të bashkisë në lidhje me krijimin e regjistrit të dhuratave dhe detyrimet e tyre për deklarimin e dhuratave;
- ✚ Hartimi i procedurave të brendshme për trajtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve rreth administrimit të pronave bashkiake;
- ✚ Parashikimim i pozicionit të koordinorit për të drejtën e informimit në strukturën institucionale;

Konkluzione dhe Rekomandime

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për vitin 2023, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të dhënave analitike të raportuara dhe të analizës së kryer, rezulton se:

- Bashkia Roskovec ka vijuar me zbatimin e planit të Integritetit duke realizuar një nivel të mirë të realizimit të masave të planifikuara për integritetin në (61-80) për vitin 2023, për sa i përket realizimit të objektivave ka arritur një nivel të mirë realizimi në objektivin e dytë 69% (61-80) % duke sjellë një impakt pozitiv në përmirësimin e rritjes së nivelit të integritetit në institucion.
- ✓ Të vijohet me zbatimin dhe raportimin e masave dhe angazhimeve të evidentuara më sipër që vijnë të jenë në proces apo janë të përfunduara, sipas fushave të etikës, burimeve njerëzore dhe fushave të veçanta të përgjegjësisë
- ✓ Të fokusohet vëmendja në realizimin e masave/aktiviteteve sipas fushave të ndyshme funksionale në nivel bashkie
- ✓ Përmirësimi i kapaciteteve në strukturat/institucionet përkatëse për zbatimin dhe raportimin sipas metodologjisë së monitorimit të PI.